# DËSHMI ARKIVI

**A-476462**

VERSIONI 1

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Deklarata e ambasadores amerikane trondit Athinën, opozita kërkon shpjegime |
| ADRESA | `https://lapsi.al/deklarata-e-ambasadores-amerikane-trondit-athinen-opozita-kerkon-shpjegime-i1094640` |
| BURIMI | lapsi.al |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 28 shtator 2026, 13:27:00 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 28 shtator 2026, 13:25:59 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `d9cd49cee6d92e9bbe8c29258f791aca74c6217ddac48533910c17406b883175` |
| TEKSTI | `518a71849cfea8e936db34f71caeee1043b971129d15c83f4acc0dd74a4fad30` |
| PAMJA | `d0d0ed57a8eab18366b997f39a535922d412d90cb42b9c662e453681964ea64f` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `6fe294921eca2db083625d423b5bb854fc47cde5d5dc9e167d0adfd6c05c20fb` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `c9da2c073e2a83be1965121fd231137d695108173d39514ad5452b64d4c51b05` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/6fe294921eca2db083625d423b5bb854fc47cde5d5dc9e167d0adfd6c05c20fb`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

# Deklarata e ambasadores amerikane trondit Athinën, opozita kërkon shpjegime

LAPSI.AL • 28 SEPTEMBER 2026



Partitë opozitare në Greqi i kanë kërkuar qeverisë të japë shpjegime pas një raportimi të "Wall Street Journal", sipas të cilit ambasadorja amerikane në Greqi dyshohet se ka deklaruar se Shtetet e Bashkuara kishin qenë të përfshira në rrëzimin e qeverisë së Rumanisë dhe se mund të bënin të njëjtën gjë edhe në Greqi.

Sipas "Wall Street Journal", ambasadorja amerikane Kimberly Guilfoyle dyshohet se i bëri këto deklarata gjatë një darke në muajin mars, ku merrnin pjesë zyrtarë grekë dhe amerikanë.

Lexo gjithashtu



27 SHTATOR, 12:41

**WSJ: Si e ndihmoi ambasadorja amerikane kompaninë greke të siguronte marrëveshjen 6 miliardë $ në Shqipëri**

Duke iu referuar rrëzimit të pritshëm të qeverisë së qendrës së djathtë të Ilie Bolojan në Rumani, Guilfoyle dyshohet se i tha ministrit grek të Energjisë, Stavros Papastavrou, se Shtetet e Bashkuara kishin qenë të përfshira në largimin e saj nga pushteti.

> **"Ne mund t'ia bëjmë këtë çdo vendi që duam. Mund ta bëjmë edhe këtu", citohet të ketë thënë Guilfoyle, sipas një personi që kishte marrë pjesë në darkë dhe personave të tjerë që ishin informuar më pas për incidentin.**

Sipas burimeve të gazetës, Papastavrou iu përgjigj se Shtetet e Bashkuara nuk mund ta zëvendësonin qeverinë greke, pasi ajo ishte zgjedhur nga populli. Avokati i Guilfoyle e ka kundërshtuar versionin e bisedës të paraqitur nga "Wall Street Journal".

> **"Qeveria, dhe konkretisht ministritë kompetente të Punëve të Jashtme dhe të Mjedisit dhe Energjisë, janë të vetmet që kanë autoritetin për të dhënë çdo shpjegim të nevojshëm dhe për t'iu përgjigjur vërtetësisë së raportimit të publikuar", deklaroi PASOK në një njoftim për shtyp.**

## ide



**Një histori korruptimi jo dashurimi**

Blendi Kajsiu



**Gysi, Bela, Lali, Klodi si maska të një njeriu të vetëm**

Andi Bushati

MOTI TIRANA 25°C | KËMBIMI EURO 91.97

## aktuale

15:00

**Rama lan duart me skandalin e SHISH: Çështje individuale e Vlora Hysenit me drejtësisë**

22:06



Rama niset sot drejt Shqipërisë, mesazh urgjent shqiptareve nga Rinasi direkt pas kthimit

PROMO




**TIA dhe Vodafone sjellin teknologjinë Airbus në Tiranë**

Ndiqe Lapsin edhe në

Me interes nga publiku



> publikuar", deklaroi PASOK në një njoftim për shtyp.
> **"Greqia është një demokraci e pavarur dhe sovrane dhe ka për detyrë të veprojë si e tillë në çdo rast dhe ndaj të gjitha palëve, pa përjashtim", shtoi partia.**

Aleanca e së Majtës Greke (ELAS) i cilësoi deklaratat e pretenduara si "të paprecedenta dhe të papranueshme".

> **"Qeveria vazhdon të heshtë, pa e konfirmuar dhe pa e mohuar incidentin. Për këtë arsye, i bëjmë thirrje qeverisë Mitsotakis t'i sqarojë menjëherë popullit grek nëse incidenti në fjalë ka ndodhur vërtet; nëse po, përse është mbajtur i fshehtë që prej muajit mars; dhe nëse, dhe në çfarë mënyre, ka reaguar qeveria."**

Edhe SYRIZA deklaroi se zbulimet "janë jashtëzakonisht serioze dhe qeveria nuk mund të vazhdojë të heshtë".

> **"Nëse janë të vërteta, nuk kemi të bëjmë me një incident të thjeshtë diplomatik, por me një cenim të vetë sistemit qeverisës të vendit", deklaroi partia.**

SYRIZA i kërkoi gjithashtu qeverisë të shpjegojë përse këmbëngul në promovimin e Korridorit Vertikal të Gazit dhe në "rritjen e mëtejshme të varësisë së Greqisë nga LNG-ja amerikane".

Partia Komuniste e Greqisë (KKE) deklaroi se qeveria "mban një përgjegjësi të rëndë", duke iu referuar edhe vizitës së pritshme në Greqi, brenda pak ditësh, të Sekretarit amerikan të Shtetit, Marco Rubio. Sipas KKE-së, vizita synon avancimin e mëtejshëm të planeve amerikane në rajon dhe rinovimin e marrëveshjes strategjike Greqi-SHBA.

Guilfoyle ka luajtur një rol të rëndësishëm në promovimin e Korridorit Vertikal të Gazit, një projekt rajonal infrastrukture që synon transportimin e gazit nga Greqia, përmes Bullgarisë dhe Rumanisë, drejt Europës Qendrore dhe Lindore, si një alternativë ndaj gazit rus./ Përkthyer nga **Ekathimerini.com**

## Të këshilluara



**Arrestohet mësuesi 60-vjeçar në Lushnje, ngacmoi seksualisht vajzën 13-vjeç**

Një mësues 60-vjeçar në Lushnjë i cili dyshohet se ka ngacmuar seksualisht, përmes mesazheve, një nxënëse 13-vje...



**Këshilli i Sigurimit presion prokurorëve të SPAK? "Çështjet individuale të mos kthehen në krizë besimi ndaj shtetit"**

Këshilli i Sigurimit ka dalë me një deklaratë pas arrestimit të ish-shefes së SHISH, Vlora Hysenit me të cilën i të...






**Rama sulmon dy televizione: Lavatriçe mediatike, kanë marrë peng një Prokurori**



Pse nuk bind alibia e kryeministrit "leshko", që nuk e dinte për Vlora Hysenin dhe Ergys Agasin



WSJ: Si e ndihmoi ambasadorja amerikane kompaninë greke të siguronte marrëveshjen 6 miliardë $ në Shqipëri



Një histori korruptimi jo dashurimi



## Përplasje brenda GJKKO-së: Si duhet trajtuar bojkoti i avokatëve



### Tabaku: Shqipëria nuk vuan nga "republika e prokurorëve", por nga republika e të korruptuarve

Deputetja e Partisë Demokratike kërkon përgjegjësi politike për korrupsionin, transparencë për PPP-të dhe prokurimet, si dhe institucione që nuk veprojnë jashtë kontrollit ligjor.



### Aksidentet rrugore rriten me 6.2% në tetë muaj, më të rrezikshmet Tirana dhe Durrësi

Aksidentet rrugore u rritën me 6.2% në tetë muajt e parë të vitit 2026, të nxitura kryesisht nga një shtim i fortë i ra...



### Deklaratë unanime për UÇK-në/ Kuvendi i Kosovës kundërshton Hagën

Kuvendi i ri i Kosovës ka miratuar të hënën, në seancën e tij të parë plenare, një deklaratë lidhur me aktgjy...




## Vodhën 6 makina në Kavajë, Durrës dhe Tiranë, në pranga 2 autorët



### Autorët u paraqitën si Taulant Balla: Si u tentua zhvatja e Armand Dukës për 100 mijë euro

Dy të rinj janë arrestuar në kuadër të një operacioni të zhvilluar në Tiranë, pas dyshimeve se kanë tentuar t...



### Burimas/ Sherr mes banorëve dhe policisë për ujin e pijshëm, kolapsohet një qytetar

Protesta e tretë e banorëve të Burimasit kundër projektit për furnizimin me ujë të Zvezdës është shoqëru...

### PDK-ja e gatshme të diskutojë për presidentin



PDK-ja e gatshme të diskutojë për presidentin, nëse kalon projektligji për Specialen

Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Bedri Hamza, ka thënë se nëse miratohet projektligji për ndryshimin dhe plo...

## Me sytë katër



19:19

### VIDEO/ Qëllohet me vezë kryeministri hungarez Péter Magyar

Një incident ka ndërprerë fjalimin e kryeministrit hungarez Péter Magyar gjatë një aktiviteti elektoral në qytetin e Szoln...



VIDEO/ Theu derën e supermarketit në Vlorë dhe mori kasën, por u arrestua

17:23



"Më shau, e shava"/ Shefi i komisariatit të Krujës flet pas pamjeve të shpullës

21:35



PAMJET/ Protestuesit kapin Bledi Çuçin në kafe, bashkëshortja e tij Delina Fico humb durimin

23:13



VIDEO/ Muriqi feston me bluzën e UÇK-së golin ndaj Irlandës

22:44

## SPORT

Të tjerë artikuj



13:59

Aedan Scipio, futbollisti me flokët e lidhur në bel: dy lojtarë u përjashtuan se i tërhoqën gërshetat



13:31

Maran humb Caken për San Marinon, dërgon në shtëpi Simonin: Kombëtarja heq dorë nga stërvija zyrtare



13:00

Irlanda mposhti Izraelin brenda e jashtë fushës në ndeshjen e polemikave: koka ulur gjatë himnit, festim për Gazën



12:54

Përkthyesi i teknikut Mancini në vështirësi për një pyetje të sikletshme para Turqi-Itali: "Çfarë të bëj?"



12:17

Manchester City thyen heshtjen pas vendimit: "Ka shumë gjëra që nuk mund t'i themi"



11:05

Asnjë udhëtim në Turqi për 10 lojtarë të Italisë: Mancini lë në shtëpi Barella dhe Mancini




22:12

Lojtarët e Irlandës refuzojnë të shtrëngojnë duart me skuadrën e Izarelit

PAPARAZZI




Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.